



Universiteti i Gjirokastrës mori pjesë në Takimin e 14-të Online të Projektit Erasmus+ SINCERE

Universiteti i Gjirokastrës mori pjesë në Takimin e 14-të Online të projektit Erasmus+ SINCERE (Strengthening Integrity and Combating Corruption in Higher Education), ku partnerët e konsorciumit diskutuan progresin e aktiviteteve dhe planifikimin e hapave të ardhshëm të projektit. Në kuadër të Paketës së Punës WP1, u shqyrtua përgatitja e raportit të brendshëm për periudhën e parë gjashtëmujore të projektit (tetor 2025 – mars 2026), ku do të përfshihen kontributet e partnerëve, raportimin financiar, zbatimin e Planit të Cilësisë, monitorimin e treguesve të cilësisë, si dhe përditësimin e vlerësimit të rrezikut dhe dokumenteve strategjike të projektit.

Gjatë diskutimeve për WP2, koordinatori I projektit (UNIKO), evidentori progresin në hartimin e Kornizës së Integritetit Akademik (Academic Integrity Framework).

Në kuadër të WP3, u diskutuan procedurat për prokurimin e softuerit antiplagjiaturë, zhvillimi i panelit të monitorimit të inteligjencës artificiale, specifikimet teknike të pajisjeve për institucionet partnere, si dhe koordinimi për hartimin e moduleve të ardhshme të trajnimit. Takimi trajtoi gjithashtu aktivitetet e Paketës së Punës WP4, të lidhura me organizimin e eventeve të brendshme të shpërndarjes së rezultateve, përditësimin e faqes zyrtare të projektit, analizën e aktivitetit në rrjetet sociale dhe planifikimin e aktiviteteve promovuese për muajt në vijim, përfshirë publikimin e buletinit të parë elektronik vjetor.

Pjesëmarrja e Universitetit të Gjirokastrës në projektin Erasmus+ SINCERE përforcon angazhimin institucional për promovimin e integritetit akademik, transparencës dhe kulturës etike në arsimin e lartë, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.